

VENDIM
Nr. 349, datë 28.12.2022

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALB ENERGY TRADE” SHPK NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2116/7 prot., datë 23.12.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Alb Energy Trade’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 283, datë 7.11.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 9.11.2022 dhe 10.11.2022), si dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, dhe, në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 18.11.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1770/6 prot., datë 14.11.2022 dhe nr. 1840/4 prot., datë 17.11.2022, datë 6.12.2022, shoqëria ka depozituar në ERE dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Pas shqyrtimit në mbledhjen e Bordit të datës 30.11.2022, të relacionit nr. 1999/4 prot., datë 24.11.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimeve, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, nga Bordi u la detyrë që të sqarohet me shoqërinë e të dokumentohet se shoqëria disponon në fondet e saj vlerën përkatëse financiare, sipas parashikimeve të planit të biznesit.

- ERE, me shkresën nr. 1840/6 prot., datë 1.12.2022, i kërkoi shoqërisë të depozitojë sa më sipër citohet. Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 1840/7 prot., datë 6.12.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e kërkuar.

- Me vendimin nr. 316, datë 9.12.2022, Bordi i ERE-s vendosi të zgjasë me 20 (njëzet) ditë vendimmarrjen e tij mbi aplikimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k., duke i lënë shoqërisë detyrimin që brenda 10 (dhjetë) ditëve të depozitojë në ERE sqarimet përkatëse, në lidhje me dokumentacionin/mbështetjen financiare, që vendos në dispozicion të ushtrimit të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE njoftoi shoqërinë për vendimmarrjen e mësipërme me shkresën nr. 1840/8 prot., datë 15.12.2022. Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1840/9 prot., datë 20.12.2022, dhe *e-mail*-in e protokolluar në ERE me nr. 1840/10 prot., datë 22.12.2022, ka depozituar dokumentacionin e kërkuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Alb Energy Trade” sh.p.k. ka plotësuar të gjithë dokumentacionin në zbatim të rregullores së licencimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Alb Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti